

KËRKESË

Kërkues: Av. Arben Llangozi, me nr liçence 8459, antar i dhomës së avokatisë Tiranë, me seli Rruga Teodor Keko, pallati Alfa Bank, kati i tretë, Tiranë.

Objekti: Kërkojmë fillimin e proçedimit disiplinor për komisioneren Etleda Çiftja, pasi është duke ushtruar detyrën në kundërshtim me, Ligji Nr.84/2016 Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i KEDNJ, Neni 4,13,30,31, të Kodit të Proçedurave Administrative.

Kërkojmë pezullimin nga detyra të pandehurës Etleda Çiftja, pasi komisionerja është marrë e pandehur nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për një vepër të rëndë penale të kryer me dashje, atë të “falsifikimit” në formë përdorimi të dokumentave zyrtar.

Kërkojmë nga oranzata “Guinness Eorld Records” të regjistroj si rastin më të rrallë në botë emrin e komisioneres Etleda Çiftja, si një e pandehur që gjykon gjyqtarët.

Baza Ligjore:Ligji Nr.84/2016 Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Neni 42 I Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ, Neni 4,13,30,31Të Kodit të Proçedurave Administrative.

Drejtuar:

1. Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. **Kshillit të Lartë Gjyqësor.**
3. Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
4. **Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) Steven Kessler.**
5. Guinness Eorld Records

Të nderuar:

1.1 Unë kërkuesi jam me profesion avokat dhe përfaqsoj në KPK Subjektin e rivlersimit, Andri Ymeri, me detyrë Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, **i cili ka kryer dy seanca gjyqësore në këtë kolegji me një të pandehur dhe jo me një gjyqtare.**

1.2 Ky subjekt që unë përfaqsoj është duke kaluar rivlersimin kalimtar, sipas ligjit Nr.84/2016 Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në datë 16.12.2019 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ka vendosur për përfshirjen Gjyqtarit Andri Ymeri në shortin special. Për hetimin administrative dhe

gjykimin e tij, është caktuar trupa gjyquese e përbërë nga Roland Ilia, Relator, Pamela Qirko, Kryesuese e seancës, dhe Etleda Çiftja antare e këtij komisioni.

1.3 Në seancën e datës 13.06.2022, unë në Av. Arben Llangozi, në kam paraqitur shqetësimin se trupa Gjyquese, dhe pikërisht antarja Etleda Çiftja, plotëson kushtet për të qënë gjyqtare, sipas parashikimeve dhe të drejtave të mija kushtetuese e përcaktuar në *nenin 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se: Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Komisionerja Çiftja nuk plotëson edhe kushtet e një punonjese publike, dhe aq më tepër të një antareje Kolegji kjo referuar ligjeve në fuqi.*

1.4 Në të gjitha mediat është publikuar fakti se Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, SPAK ka marrë të pandehur anëtarin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, KPK, Etleda Çiftja, fakt ky tashmë i njohur botërisht sipas parashikimeve të nenit 13 të Kodit të Procedurës Civile. Koordinatorja për mediet në “SPAK”, Xhuljeta Krasta, ka pohuar se ndaj komisioneres Etleda Çiftja, rëndojnë akuzat “deklarim i rremë” dhe “falsifikim” në formë përdorimi. Po ashtu, Krasta sqaroi se deklarimi i rremë është kryer nga Çiftja në komisionet e përzgjedhjes së saj për një pozicion në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Komisionerja Etleda Çiftja, nuk ka reaguar por vijon punën normalisht duke u bërë kështu rasti unik në botë që një i pandehur gjykon gjyqtarin. Si në jurisprudencë, por edhe në fakt gjyqtari gjykon të pandehurit, por rasti i Etleda Çiftes, është unik dhe është rasti i vetëm në botë, që një pandehur gjykon gjyqtarët dhe prokurorët.

1.5 Bazuar në ligjin Nr.84/2016 Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i cili shpjegon në mënyrë specifike në nenin 17 të tij, Procedurat për shkarkimin e anëtarit të institucioneve të rivlerësimit. Në rast se ka të dhëna të mjaftueshme nga burime të besueshme se anëtarin e institucioneve të rivlerësimit ka kryer një shkelje disiplinore, ndaj tij fillon hetimi disiplinor. Subjektet që mund të kërkojnë fillimin e hetimit disiplinor janë: **a) çdo komisioner për komisionerët, pra komisionerët nuk i kërkojnë KPA procedim disiplinor. Në nenin 16 të këtij ligji Përgjegjësia disiplinore e anëtarit të institucioneve të rivlerësimit**

14. Shoqërimit me persona që janë nën ndjekje penale

ose janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar penalisht, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose personave të cilët janë të afërm me gjyqtarët në lidhje gjaku ose me ligj, si dhe marrëdhëniet e biznesit të papërshtatshme me këta persona. Pra përgjegjësia disiplinore sipas ligjit Nr.84/2016 Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve , në Republikën e Shqipërisë neni 16 pika 14 është jo vetëm e për shkeljet e komisioneres së pandehur Çiftja, por edhe e të antarëve të komisionit që shoqërohen me të cilët e kanë kontakt të paparështatshëm.

1.6 Ushtrimi i detyrës së komisioneres nga ana Etleda Çiftja, në procesin tim të rivlersimit, cënon në mënyrë të drejtpërdrejtë, Nenin 4 të Kodit të Proçedurave Administrative i cili ka të bëjnë me Parimin e ligjshmërisë 1. **Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,** me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.por si mund të mos më cenohen mua të drejtat kur para meje është duke më gjykuar komisionerja Etleda Çiftja, e cila aktualisht ka statusin e të pandehurës, në *Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.*

1.7 Ushtrimi i detyrës nga komisionerja Etleda Çiftja, na krijon bindjen se është dhe në kundërshtim me Neni 13 të Kodit të Proçedurave Administrative, që ka të bëj me, *Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie. Si mundet që gjykimin kundrejt meje ta kryej një e pandehur? Dhe mund të quhet gjykim i drejtë, kur vet fakti instiktiv e çon të pandehurin që të hakmerret kundër gjyqtarit?* Pra në rastin konkret cenohet ekzistenca e një gjyqësori efektiv dhe të pavarur,nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi egzistenca e një gjykate të tillë kërkon standarde dhe integritet të lartë të gjyqtarëve, me qëllim realizimin e misionit të tyre – dhënien e drejtësisë. Në këtë vështrim respektimi i kritereve ligjore për marrjen e vendimeve, nga ana e gjyqtarëve gjatë kohës që ushtrojnë këtë funksion, ndikon drejtpërsëdrejti në garantimin e shtetit të së drejtës. Paanshmëria është cilësi themelore që kërkohet nga një gjyqtar dhe është atribut thelbësor i gjyqësorit, ajo duhet të ekzistojë edhe si çështje faktike por edhe si çështje e perceptimit të

arsyeshëm. Nëse përceptohet se gjyqtari nuk ka vepruar në mënyrë të paanshme, atëherë ky përceptim shkakton krijimin e një ndjenje të padrejtësisë që ndikon në dëmtimin e besimit në sistemin gjyqësor. Në jurisprudencë është e shkruar se , **“drejtësia jo vetëm duhet të jepet por ajo duhet të shihet se po jepet”**, kjo do të thotë se paanshmëria e gjykatës është e kompromentuar edhe kur ajo është thjeshtë e dyshimtë, por ky dyshim është i arsyeshëm për një standart mesatar interpretimi. Pra, mjafton që palët të krijojnë një dyshim të përligjur mbi paanësinë e gjykatës që shtetit ti lind detyrimi për të bërë verifikimet përkatëse dhe për të marrë masat e nevojshme, për arritur në konkluzionin se gjyqtari nuk plotëson kushtet. **Dhe drejtësia në të gjitha çështjet gjyqësore kundër gjyqtarëve, duket se po jepet nga e pandehura Etleda Çiftja dhe jo nga një funksionar i lartë drejtësie siç realisht duhet të ishte.**

- 1.8 Ushtrimi i detyrës nga komisionerja Etleda Çiftja, na krijon bindjen se është dhe në kundërshtim me nenin 30 të K.P.A. që ka të bëjë me Pengesat ligjore, **Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur:**h) në çdo rast kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi, pasi në ligjin ligjin Nr.84/2016 Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë në nenin 16 pika 14 ligji e ka quajtur kontakt të papërshtatshëm faktin e shoqërimit me të pandehur jo më i pandehuri të gjykoj, në analizë sa parashtruar më sipër i përforcojmë trupës gjykuese që po gjykon këtë kërkesë për përjashtim, të ketë parasysh edhe dy vendimmarrje të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, dhe pikërisht të Mbledhja e Gjyqtarëve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, më 7 shkurt, ku ka vendosur të pezullojë nga detyra anëtarin Ardian Hajdari. Dhe në një njoftim për shtyp KPA shpjegoi se Hajdari është pezulluar pasi është marrë i pandehur nga Prokuroria Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. I cili ka qënë në të njëjtat kushte si ato të ndodhura të të pandehurës Etleda Çiftja. Një tjetër proces disiplinor ka filluar edhe për Luan Dacin, dhe në KPA, kërkesa në këtë rast u inicua nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.
- 1.9 Komisionerja Etleda Çiftja, ka pasur detyrë të deklaronte faktin e pengesave ligjore dhe faktin e marjes së saj si e pandehur kjo sipas parshikimeve të nenit 31 të Kodit të Procedurave Administrative që ka të bëjë me Vetëdeklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përjashtim
1. **Nëse nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal të organit publik vëren një nga pengesat e parashikuara në nenin 30, të këtij Kodi, ai njofton menjëherë me shkrim**

eprorin e tij ose organin kolegjal. 2. Çdo nëpunës tjetër, i cili ka dijeni mbi rastet e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 30, të këtij Kodi, njofton në përputhje me pikën 1 të këtij neni. 3. Pala mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtari të organit kolegjal nga një procedurë administrative, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet eprorit dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet. 4. Në çdo rast, deri në marrjen nga eprori të një vendimi përfundimtar, nëpunësi pezullohet nga procesi vendimmarrës. Por asnjë nga detyrimet e nenit 31 të Kodit të Proçedurave Administrative, nuk po zbatohet në proçesin e rivlersimit kundër meje, duke lejuar një të pandehur të më gjykoj mua në cilësinë e gjyqtarit.

1.10 Njëkohësisht me anën e kësaj kërkesë kërkojmë dhe nga Guinness Eorld Records, të marin masa dhe të të regjistroj si rastin më të rrallë në botë emrin e komisioneres Etleda Çiftja, si një e pandehur që gjykon gjyqtarët, pasi në çdo vënd të botës ndodh që i pandehuri gjykohet nga gjyqtarët por në shqipëri ndodh se i pandehuri gjykon gjyqtarët.

Për sa më sipër Ligji Nr.84/2016 Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Neni 42 I Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ, Nneni 4,13,30,31, të Kodit të Proçedurave Administrative.

KËRKOJMË:

1. Kërkojmë fillimin e proçedimit disiplinor për komisioneren Etleda Çiftja, pasi është duke ushtruar detyrën në kundërshtim me, Ligji Nr.84/2016 Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i KEDNJ, Neni 4,13,30,31, të Kodit të Proçedurave Administrative.
2. **Kërkojmë pezullimin nga detyra të pandehurës Etleda Çiftja, pasi komisionerja është marrë e pandehur nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për një vepër të rëndë penale të kryer me dashje, atë të “falsifikimit” në formë përdorimi të dokumentave zyrtar.**
3. **Kërkojmë nga oranzata “Guinness Eorld Records” të regjistroj si rastin më të rrallë në botë emrin e komisioneres Etleda Çiftja, si një e pandehur që gjykon gjyqtarët.**

KËRKUESI

Av Arben Llangozi

